



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCËVE  
MUZEU ARKEOLOGJIK AUTONOM



Miratohet  
Akad. Skënder Ç. JINUSHI  
KRYETAR

STATUTI  
I  
MUZEUT ARKEOLOGJIK AUTONOM

Tiranë, 2024

## KREUI DISPOZITATË PËRGJITHSHME

### Neni 1 Objekti

Ky Statut përcakton parimet bazë të funksionimit dhe mënyrën e organizimit të Muzeut Arkeologjik Autonom (në vijim MAA) pranë Akademisë së Shkencave, si një muze me funksione arkeologjike, historike dhe edukative. Muzeu ka stemën e tij, sipas lidhjes nr. 1, bashkëngjitur.

### Neni 2 Baza juridike

MAA është institucion muzeor autonom, buxhetor, veprimtaria e të cilit mbështetet në ligjin nr. 53/2019 "Për Akademinë e Shkencave", i ndryshuar, ligjin nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", në këtë Statut, në rregulloren e tij dhe në standartet e International Council of Museums-ICOM/ Këshillit Ndërkombëtar të Muzeve-KNM.

### Neni 3 Misioni dhe vizioni

MAA ruan, promovon dhe dokumenton përmes koleksionit muzeor që administron, trashëgiminë kulturore dhe materiale (arkeologjike të luajtshme) të zbuluar në territorin e Republikës së Shqipërisë, kryesisht nëpërmjet kërkimeve të realizuara nga Instituti i Arkeologjisë dhe e paraqet atë për publikun vendas dhe të huaj konform standardeve të gjithëpranuara muzeore.

- 3.1 Misioni i MAA është koleksionimi, ruajtja dhe kërkimi i trashëgimisë arkeologjike, prezantimi i saj në perspektiva të ndryshme në kontekste arkeologjike dhe historike, duke patur parasysh publikun e ndryshëm, për të kontribuar në shtimin e njohurive dhe rritjen e pëlqyeshmërisë për vlerat arkeologjike dhe historike, si një simbol identiteti për territorin shqiptar.
- 3.2 MAA ka si vizion të jetë një qendër dinamike ku kërkimi shkencor mundëson progres për njohuritë shkencore në arkeologji. MAA me koleksionin e tij unikal (i vetmi koleksion arkeologjik nga prehistoria në mesjetë me mbulim të tërë territorit shqiptar), programet e ekspozimit, edukimit, ruajtjes dhe restarurimit etj, synon të kthehet në një qendër muzeale të rëndësishme në vend.
- 3.3 Qëllimet e muzeut janë:
  - a) Promovimi i fondit arkeologjik të MAA direkt dhe indirekt nëpërmjet ekspozimit të përhershëm dhe të përkohshëm, ofrimin e materialeve me përmbajtje arkeologjike, historike, edukative në funksion të tematikave të muzeut, përmes prezantimit direkt dhe mjeteve të tjera bashkëkohore të komunikimit.
  - b) Huluntimi, mbledhja, ruajtja, studimi shkencor dhe mbrojtja afatgjatë e fondit muzeor të MAA si pasuri me vlerë kombëtare, materiale dhe kulturore.
  - c) Ofrimi i një hapësirë të re edukative për publikun ku organizohen programe edukative

për grupe të ndryshme interesi me qëllim kultivimin e një kulture arkeologjike dhe historike në shoqëri.

- ç) Shërbimi i informimit dhe edukimit të shoqërisë në fushën e arkeologjisë, rolit të MAA, si edhe edukimit në fushën e arkeologjisë, arkeologjisë publike dhe historisë antike.

## KREU II PARIMET DHE DETYRAT

### Neni 4

#### Detyra dhe funksionimi i Muzeut Arkeologjik

I. Muzeu Arkeologjik ka këto detyra:

- a) Zbaton politikën e Akademisë së Shkencave, Ministrisë përgjegjëse për Kulturën, në fushën e trashëgimisë kulturore, materiale dhe jo materiale, përmes ekspozimit, hulumtimit, inventarizimit dhe katalogimit digjital, pasurimit të fondit muzeor, mbrojtjes dhe restaurimit të këtyre vlerave që i ka në administrim dhe përmes vizitave dhe organizimit të aktiviteteve të veçanta.
- b) Prezanton tek vizitorët vendas dhe të huaj vlerat arkeologjike dhe historike, objektet e ekspozuara dhe tematikat e muzeut.
- c) Përcakton objektet për t'u ekspozuar dhe dokumentimin e tyre sipas kritereve shkencore.
- ç) Nxit dhe inkurajon dialogun për trashëgiminë kulturore mes tyre.
- d) Përgatit pasaportën shkencore të çdo objekti ekzistues apo të ri, që hyn në fondet e tij, të cilat regjistrohen në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Regjistrimi i hyrjes dhe i çdo ndryshimi, lëvizje hyrje-dalje apo ndryshim pronësie të objekteve të ekspozuara në MAA.
- dh) Pasuron dhe plotëson në vazhdimësi fondin muzeor të MAA, panelet që lidhen me përmbajtjen dhe tematikat e muzeut.
- e) Organizon programe edukative brenda dhe jashtë ambienteve të MAA në funksion të promovimit të vlerave arkeologjike, historike dhe edukative.
- ë) Komunikon në vijimësi me institucione arsimore të vendit, dhe në bashkëpunim me to, harton programet e përbashkëta edukuese.
- f) Rrit qasjen e muzeut për publikun me nevoja të veçanta.
- g) Organizon brenda dhe jashtë vendit çeljen e ekspozitave, me objektet që disponon në përputhje me legjislacionin shtetit shqiptar.
- gj) Realizon botime të ndryshme, periodikësh shkencorë, kartolinash, albumesh, guidash, riprodhimesh etj., për propagandimin e vlerave arkeologjike kulturore.
- h) Nxit dhe inkurajon nëpërmjet projekteve veprimtarinë kërkimore-shkencore të studentëve, punonjësve në fushën e arkeologjisë.
- i) Organizon takime pune, tryeza të rrumbullakëta, debate, kurse, seminare apo konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim kualifikimin e studentëve dhe punonjësve të sistemit muzeor dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e muzeologjisë.
- j) Organizon veprimtari për ngjarje e personalitete të shquara dhe ekspozita, organizon seminare, që përshtaten me specifikën e tij.
- k) Bashkëpunon me muze të veçanta brenda dhe jashtë vendit.

## **Neni 5** **Bashkëpunimi ndërinstitucional**

1. MAA për përmbushjen e veprimtarisë së vet, bashkëpunon me organet e administratës shtetërore qendrore, me organet e qeverisjes vendore, me muzetë kombëtarë, muzetë autonomë, muzetë vendorë, muzetë privatë, me institucione të tjera të specializuara si, Institutin e Monumenteve të Kulturës, Galerinë Kombëtare të Arteve, Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Arkivin Qendror të Filmit, për të ekspozuar fondet e tij objekte me vlera të veçanta, si edhe për ekspozita të përbashkëta.
2. Muzeu bashkëpunon me institucione shkencore, arsimore, kulturore, artistike dhe fetare, si dhe persona fizikë dhe juridikë, privatë, për evidentimin, grumbullimin dhe restaurimin e objekteve që janë vlera materiale të trashëgimisë kulturore. MAA, në bashkëpunim me to koncepton dhe ri koncepton pavijone ekzistuese apo të reja.

## **Neni 6** **Bashkëpunimi ndërkombëtar**

1. MAA bashkëpunon me organizma të huaj simotra nëpërmjet marrëveshjeve me interes reciprok të tilla që mund të çojnë edhe në binjakëzimin, apo forma të tjera bashkëpunimi përmes Akademisë së Shkencave.
2. MAA mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me ente, subjekte privatë apo shtetërore të huaj, me qëllim realizimin e projekteve të financimit, ekspozimit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore promovuese të kulturës kombëtare vendase dhe asaj të huaj.

## **KREU III** **ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI FINANCIAR**

### **Neni 7** **Struktura Organizative**

Struktura dhe organika e Muzeut Arkeologjik Autonom miratohet me vendim të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me propozim nga Instituti i Arkeologjisë, sipas lidhjes nr. 2, bashkëngjitur.

### **Neni 8** **Organet drejtuese**

1. Drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë së Muzeut realizohet sipas përcaktimeve në vendimin e Kryesisë së Ash-së dhe rregullores së brendshme të tij.
2. Përgjegjësi i Muzeut Arkeologjik Autonom emërohet me vendim të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e ASHSH.

### **Neni 9** **Këshilli Shkencor i Muzeut Arkeologjik Autonom**

1. Këshilli Shkencor është organizëm kolegjal këshillimor pranë Muzeut Arkeologjik Autonom, i cili miratohet nga Kryetari ASHSH me propozim të drejtorit të Institutit Arkeologjik. Këshilli

---

Adresa: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, sheshi "Fan Noli", Tiranë, tel & fax.: 0(4)2227476; www.akad.gov.al

udhëheq veprimtarinë muzeore si dhe proceset e pasurimit dhe të rikonceptimit të tij duke dhënë rekomandimet përkatëse.

2. Kryetari i Këshillit Shkencor është drejtori i Institutit të Arkeologjisë.
3. Këshilli përbëhet prej 5 personash me tituj dhe grada shkencore në fushën e arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore.
4. Anëtarët që nuk janë pjesë e organikës së ASHSH dhe institucioneve të saj të varësisë kanë të drejtën e shpërblimit. Masa e shpërblimit të anëtarëve të jashtëm përcaktohet nga Kryesia e ASH-së.

#### **Neni 10 Punësimi**

Punësimi në Muzeun Arkeologjik Autonom bëhet konform parashikimeve në rregulloren e brendshme të ASHSH-së.

#### **Neni 11 Fondi Muzeor**

1. Ruajtja, konservimi dhe menaxhimi i këtij fondi kryhet sipas rregullave të miratuara nga institucionet e specializuara në varësinë e Ministrisë përgjegjëse për Kulturën, si dhe rregullores së brendshme të Muzeut Arkeologjik Autonom. Për restaurimin e objekteve, Muzeu dhe specialistët e restaurimit pranë Akademisë së Shkencave bashkëpunojnë me institucionet e specializuara.
2. Muzeu Arkeologjik Autonom dhe Muzetë e tjerë publikë ose privatë, shkëmbejnë ndërmjet tyre objekte muzeore, pas miratimit të ministrit përgjegjës për Kulturën, në përputhje me legjislacionin shqiptar, sidhe pas nënshkrimit të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet tyre.
3. Fondet e muzeut pasurohen vazhdimisht me objekte të trashëgimisë kulturore. Për këtë funksionon një komision, i përbërë prej 7 personash, 4 specialistë të institucionit dhe 3 nga institucione të tjera të specializuara. Komisioni ngrihet me vendim të Kryesisë së ASHSH-së.
4. Objektet e reja arkeologjike të ardhura e të zbuluara nga ekspeditat arkeologjike, regjistrohen në inventarin e MAA-së dhe për to përgatiten kartelat përkatëse pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, lidhja nr.3 "Koleksioni muzeor".

### **KREU IV ORGANIZIMI FINANCIAR**

#### **Neni 12 Financimi**

1. Burimet e financimit të Muzeut Arkeologjik janë:
  - a) Buxheti i shtetit.
  - b) Të ardhurat nga shitja e biletave.
  - c) Sponsorizimet dhe donacionet.
  - ç) të ardhura të tjera të ligjshme.
2. Fondet e financimit të muzeut parashikohen cdo vit në buxhetin e ASHSH-së.
3. Formati dhe çmimi i biletës miratohen me urdhër të Kryesisë së ASHSH-së, sipas lidhjes nr. 4, bashkëngjitur.
4. Të ardhurat e realizuara nga shitja e biletave administrohen bazuar në udhëzimin e përbashkët nr.

---

Adresa: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, sheshi "Fan Noli", Tiranë, tel & fax : 0(4)2227476, www.akad.gov.al

52, datë 9.2.2015 të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Kulturës “Për krijimin dhe administrimin e ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të Ministrisë së Kulturës.”

### **Neni 13**

#### **Shfrytëzimi i ambienteve**

1. MAA ofron në kuadër të bashkëpunimit shkencor hapësirat që disponon për projekte të përbashkëta.
2. Filmimi dhe fotografimi i objekteve arkeologjike, pjesë e inventarit të Muzeut Arkeologjik, për qëllime studimi, botimi apo për qëllime të tjera, bëhet vetëm me lejen e Kryetarit të ASHSH, bazuar në ligjin nr. 27/2015 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar dhe në ligjin për ASHSH.
3. Hyrja në salla për qëllime studimi dhe kontrolli, bëhet pas dhënies së miratimit nga drejtuesi i muzeut, pas kërkesës me shkrim të subjektit kërkuar.

### **Neni 14**

#### **Plani dhe raporti i punës**

Muzeu Arkeologjik Autonom paraqet në Kryesinë e ASHSH-së për çdo datë 30 të muajit qershor, projektplanin e veprimtarive dhe të investimeve për vitin e ardhshëm, të shoqëruar nga preventivat përkatës.

## **KREU V**

### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 15**

#### **Ndryshimet në statut**

Ky statut përmirësohet sa herë që praktika e punës dhe ndryshimet në legjislacionin e bëjnë të nevojshëm një gjë të tillë. Ndryshimet në statut mund të propozohen edhe nga titullari i institucionit. Miratimi i ndryshimeve bëhet nga Kryesia e ASHSH.

### **Neni 16**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky statuti hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kryetari Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE

*Strukura dhe organika e Muzeut Arkeologjik Autonom*

*Lidhja nr. 2*

|   |     |
|---|-----|
| <b>Nr. punonjësve gjithsej:</b>             | 5   |
| <b>Përgjegjës me kohë të plotë</b>          | 1   |
| <b>Ciceronë</b>                             | 2   |
| <b>Restaurator</b>                          | 1   |
| <b>Punonjës mbështetës me kohë të plotë</b> | 1   |
| <b>Pastrues</b>                             | (1) |

Adresa: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, sheshi "Fan Noli", Tiranë, tel.: 4 223 0305, fax.: 4 222 7476; [www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)